

PRAKTIKAT BASHKËKOHORE TË TRAJNIMIT NË FUNKSION TË PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË AUDITUESE TË KLSH

*nga Gjovalin PREÇI¹ - Kryeauditues,
botuar në gazetën "Tirana Observer", më 04 prill 2015.*



Në mjedisin e sotëm të pasigurt ekonomik dhe financiar, më shumë se kurrë, qytetarët ju kërkojnë llogari qeveritarëve dhe administratorëve të njësive publike për mënyrën se si përdoren fondet shtetërore, si dhe sa arrijnë për të dhënë rezultate dhe shërbime më të mira publike. Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni suprem i auditimit të sektorit publik, detyra kryesore e të cilit është të shqyrtojë në se fondet publike shpenzohen me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet, në përputhje kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës. Mirëfunksionimi i KLSH luan rol të rëndësishëm në kryerjen e auditimeve cilësore, duke identifikuar problematikën e subjektit dhe rekomandimin e rrugëve në të cilat njësitë publike mund të përmirësojnë veprimtarinë e tyre ekonomike dhe financiare. Duke siguruar parlamentin, taksapaguesit dhe opinionin publik mbi nivelin e grumbullimit të të ardhurave dhe mënyrën e shpenzimit të parasë, përdorimin e burimeve dhe arritjen e rezultateve, KLSH jep një

kontribut të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit dhe zhvillimin e vendit.

Pavarësisht burimeve njerëzore dhe financiare të kufizuara, KLSH ja ka arritur kryerjen me rigorozitet të auditimeve, me profesionalizëm e cilësi të lartë, me përpjekje maksimale për të arritur pritshmëritë e parlamentit, qytetarëve, medias dhe partnerëve ndërkombëtar. Rezultatet e kësaj veprimtarie audituese janë arritur krahas përmirësimeve të ndjeshme në drejtimin dhe menaxhimin e këtij institucioni, edhe nga ngritja e kapacitetit profesional të audituesve nëpërmjet formave të ndryshme të trajnimit. Ashtu siç ka theksuar Kryetari KLSH, z. Bujar Leskaj në analizën vjetore të vitit 2014, Institucioni ka forcuar kapacitetet audituese, nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm kualifikimi, kryerjes së trajnimeve të thelluara dhe gërshetimit të ngritjes arsimore me veprimtarinë praktike audituese, duke arritur që çdo auditues i KLSH të trajnohet mesatarisht 26 ditë në vit, ose mbi trefishin e viteve 2009-2011 të marra së bashku.

Në këtë kuadër nëpërmjet workshope-ve është arritur krahas trajnimeve dhe shkëmbimi i ideve, njohurive dhe eksperiencave të vendeve të tjera duke zbatuar praktikisht moton e INTOSAI-t “Experientia Mutua Omnibus Prodest”. Nga shkëmbimi i përvojave përfitojnë të gjithë. Mënyra e organizimit dhe zhvillimit, vendi dhe kohëzgjatja e tij, pjesëmarrja aktive dhe ballafaqimi i opinionëve nga të pranishmit, si dhe mbi të gjitha menaxhimi, drejtimi dhe konsolidimi i ideve dhe mendimeve të pjesëmarrësve nga ekspertë të fushës, i bëjnë workshop-et një vlerë e shtuar dhe domethënëse në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve teknike e profesionale të audituesve.

Këtij qëllimi i ka shërbyer dhe workshop-i katërt i mbajtur në Shkup të Maqedonisë (pas atyre të zhvilluar në Tiranë, Sarajevë dhe Beograd) për procesin e Auditimit Paralel të Performancës mbi Eficiencën e Energjisë për vendet Ballkanit Perëndimor, në të cilin merr pjesë Kontrolli i Lartë i Shtetit, i fokusuar në burimet alternative të energjisë. Në çdo rast është e kuptueshme mbështetja e siguruar nga institucionet e larta audituese të vendeve pritëse, si dhe duhet theksuar se punimet e workshop-eve kryhen nën drejtimin e ekspertëve të Zyrës së Auditimit të Suedisë (Riksrevisionen): znj. Christina Sand, z. Tony Angleryd dhe z. Hazim Sabanoviç, si dhe z. Dragos Budulac, Gjykata e Llogarive të Rumanisë, përfaqësues i Grupit të Përbashkët të Punës për Veprimtarinë Audituese.



Në workshop-in e muajit shkurt 2015 në Shkup kanë marrë pjesë edhe auditues nga Kosova, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, si dhe Maqedonia. Pas prezantimit të pjesëmarrësve, është organizuar një tryezë e rrumbullakët në të cilën kanë paraqitur në mënyrë të përmbledhur sa dhe si

kanë punuar grupet e auditimit, material i cili ju është vënë në dispozicion të gjithë pjesëmarrësve një javë më parë se të zhvillohej workshop-i.

Grupi i auditimit të KLSH paraqiti një përmbledhje të disa aspekteve të programit të auditimit mbi përdorimin e burimeve alternative në prodhimin e energjisë elektrike (paneleve diellore) në institucionet publike, duke u përqendruar në kontekstin social dhe ekonomik të vendit tonë, fokusimin dhe përcaktimin e problemit, kriteret e auditimit, draft-i i pyetjeve të auditimit etj. “Oponenca” e kësaj pune të grupit të auditimit të KLSH u bë nga z. Jussi Bright, aktualisht Përgjegjës i grupit për Metodologjinë e Auditimit në Gjykatën Evropiane të Auditimit (ECA), një funksion i kontrollit të cilësisë audituese brenda kësaj gjykate.

Grupi i auditimit të KLSH, në takimin ngushtë e njohu më në detaje mbi situatën në Shqipëri, të deficitit në plotësimin e kërkesës në rritje për energji elektrike dhe nevojës së diversifikimit të prodhimit, pra të përdorimit të burimeve alternative (të rinovueshme) për të siguruar qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike në miqësi me mjedisin, sipas kërkesave të direktivave të BE-së. Në këtë mënyrë, falë kushteve natyrore, potencialet e vendit tonë në prodhimin dhe konsumin e burimeve alternative të energjisë elektrike, duke ruajtur mjedisin dhe zbatuar detyrimet kontraktore të nënshkruara me Sekretariatit e Energjisë, janë të konsiderueshme. Janë institucionet publike të cilët duhet të hartojnë dhe të zbatojnë me rigorozitet iniciativa dhe veprime përkatëse për promovimin e prodhimit dhe përdorimit të energjive alternative (të rinovueshme) në kuadrin e energjisë elektrike.

Në këtë mënyrë, u konkludua se, do të përbëjnë objekt të auditimit të performancës çështjet që lidhen me transpozimin e kërkesave të direktivave të BE-së për burimet e rinovueshme në dokumentet strategjike dhe kuadrin rregullator të vendit tonë, si Strategjia Kombëtare e Energjisë, Plani Kombëtar i Veprimit për Energjitë e Rinovueshme, legjislacioni primar dhe sekondar, etj., si dhe performanca e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë në hartimin e këtyre politikave dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore në monitorimin e zbatimit të veprimtarisë publike në këtë fushë. Mbi këtë bazë, për auditimin paralel të performancës me fokus në përdorimin e burimeve alternative u rekomandua riformulimi dhe ristrukturimi i piramidës së pyetjeve të auditimit.

Nga kolegët e Kosovës u paraqit matrica e auditimit të performancës me analizën e evidencës sipas nivelit të pyetjeve të auditimit, si dhe gjetjet paraprake të auditimit të efieciencës së energjisë të shtrira deri në nivelin e njërive vendore. Grupi i auditimit të Malit të Zi është në fazën e hartimit të programit të auditimit, ai Serbisë e ka përqendruar veprimtarinë audituese në sistemin e menaxhimit të energjisë në qeverisjen lokale, Bosnja dhe Hercegovina në gjetjet paraprake të auditimit, etj.

Por në këto workshop-e integrohen tema trajnuese sipas axhendës së rënë dakord më parë, në varësi të ecurisë dhe në funksion të përmirësimit të nivelit të arritur të veprimtarisë audituese për këtë temë performance. Për këtë qëllim, me mjaft interes u ndoq tema “Metodat në auditimin e performancës - Intervistat dhe pyetësorët”, prezantuar nga z. Tony Angleryd, me përvojë të gjatë ndërkombëtare në fushën e ndërtimit të kapaciteteve

dhe konsulencës në Auditimet e Performancës, si dhe përgjegjës për përgatitjen e Udhëzimeve të Auditimit të Performancës për INTOSAI-n. Në mënyrë të natyrshme u gërshetua në praktikë me trajtesën “Zhvillimi i vrojttimeve/pyetësorëve” i finalizuar me matjen e tyre: kujdesin dhe saktësinë gjatë këtij procesi.

Një proces i rëndësishëm në ciklin e auditimit në përgjithësi dhe atë të performancës në veçanti është mbledhja dhe paraqitja e të dhënave. Pikërisht, këtu ishte përqendruar dhe tema e dy profesorëve të Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Sarajevës, duke vënë theksin në natyrën e kërkimit, përfaqshen sasiore dhe cilësore të analizës, grumbullimin e të dhënave, hapat e sondazhit, përzgjedhjen dhe përdorimin e të dhënave, karakteristikat statistikore, etj., duke e mbyllur me paraqitjen grafike të analizës së të dhënave. Vlerat e këtij prezantimi u shtuan me gërshetimin hap pas hapi me shembuj praktik, duke ndihmuar pjesëmarrësit në përdorimin e tyre gjatë veprimtarisë audituese.

Në prezantimin e Raportit të auditimit “Si llogarisin, ulin dhe shmangin efektin serë institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian”, nga z. Jussi Bright, midis të tjerave u evidentua se në tre vitet e fundit ECA ka kryer 60 auditime të performancës, duke kombinuar sipas rastit eficiencën, efektivitetin dhe ekonomikitetin, me objektivin: Bashkimi Evropian është “lojtari” më i madh në luftën kundër ndryshimit të klimës dhe për t’u bërë i besueshëm për politikën e veta është e rëndësishme që institucionet e BE-së të udhëheqin me shembullin e tyre.

Rritja e nivelit të përfitimit nga aktivitete të tilla ndërkombëtare që i shërbejnë forcimit të kapaciteteve profesionale të audituesve dhe për pasojë cilësisë së auditimit të KLSH-së, bëhet nëpërmjet zhvillimit interaktiv midis vetë pjesëmarrësve, si dhe ndërmjet këtyre të fundit dhe ekspertëve që drejtojnë dhe menaxhojnë workshop-et.

Krahas të tjerave, ngritja e kapaciteteve teknike dhe profesionale të audituesve nëpërmjet praktikave bashkëkohore të trajnimit, po reflektohet përditë e më tepër në rezultatet auditimit të KLSH-së, duke vënë gishtin atje ku të tjerët vënë dorën.

¹ *Shkrime të tjera të botuara nga Gjovalin PREÇI për periudhën janar- qershor 2015:*

- *Burimet e rinovueshme të energjisë dhe auditimi i KLSH.*
(Botuar në gazetën “Koha Jonë”, më 18 prill 2015.)
- *KLSH mbyll me sukses pjesëmarrjen në auditimin paralel të Performancës me vendet e Ballkanit Perëndimor.*
(Botuar në gazetën “55”, më 26 qershor 2015.)